

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**Këshilli Kombëtar i Ujit**

**VENDIM**

**Nr. 1 datë 7. 6. 2007**

**PËR**

**DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 2, DATË 19.07.2002, TË**  
**KËSHILLIT KOMBËTAR TË UJIT, "PËR MIRATIMIN E FORMULARËVE TË**  
**KËRKESËS PËR LEJE, AUTORIZIM E KOCENSION, SI DHE TE**  
**FORMULARËVE TIP TË DEKLARIMIT, LEJES E AUTORIZIMIT PËR**  
**PËRDORIMIN E REZERVAVE UJORE"**

Në mbështetje të neneve 6, 14 e 18 të ligjit nr. 8093, date 21.3.1996 "Për rezervat ujore", te ndryshuar, Këshilli Kombëtar i Ujit, me propozimin e ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave,

**VENDOSI:**

- I. Formulari "A" i deklarimit per perdorim te lire te ujit shfuqizohet.
- II. Formulari "B" i kërkesës për leje, për perdorim te rezerves ujore, te jete sipas modelit qe i bashkelidhet ketij vendimi.
- III. Formulari "C" i kerkeses per kocension shfuqizohet.
- IV. Formulari "D" i kerkeses per autorizim shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Lufter XHUVELI

Zv/kryetar i K.K.U.

dhe

Ministër i Mjedisit, Pyjeve dhe  
Aministrimit te Ujërave



KRYETARI

Sali BERISHA



Kërkesa për *Leje për perdorim te rezervës ujore* duhet të përmbajë formularin e autodeklarimit dhe dokumentacionin teknik:

### **AUTODEKLARIM**

Drejtuar: \_\_\_\_\_

#### ***Pjesa e Parë***

Unë i nënshkruari..... deklaroj që jam banues në adresë.....  
me seli..... Tel..... cel.....dhe me dokument identifikimi / Nr i pasaportes.....

Deklaroj nën përgjegjësinë time:

Jam i regjistruar në organet tatimore me Nr. NIPT-t.....

Jam i regjistruar në Regjistrin Tregtar me vendim .....

Nuk jam në process gjykimi, hetimi apo te jem denuar në fushën që kërkoj të ushtroj aktivitetin

Nuk kam asnje detyrim financiar ndaj anjë institucioni shtetëror

Njoh kuadrin ligjor dhe nënligjor në fushën që kërkoj të ushtroj aktivitetin

Do të zbatoj të gjitha detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi

#### ***Pjesa e dytë***

Keni liçence të mëparshme.....Po / Jo

Nëse po specifikoni fushën.....

Keni marrë leje mjedisore.....Po / Jo

Nëse akoma jo specifikoni stadin aktual.....

Nese keni eksperience lidhur me veprimtarine e kerkuar.....Po / Jo

#### ***Pjesa e tretë***

Deklaroje nën përgjegjësinë time të plotë se: të gjitha të dhënat e mësipërme janë të vërteta dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

*Jam në dijeni se në rastet kur dokumentat e sipër përmendura për marrjen e lejes kerkohen nga Autoritetet e Ujit per verifikim nuk dorezohen brenda 20 diteve dhe permbajne te dhena te paverteta unë humbas të drejten e perdorimit te lejes.Po keshtu te drejten e lejes une e humbas nese nuk informoj KBU me shkrim brenda nje muaji per ndryshimet ne pikat 3,4 dhe per gjobat e papaguara ose te pa ankimuar ne rruge gjyqesore.*

### **DOKUMENTACIONI TEKNIK**

**1.Raporti hidrologjik ose hidrogjeologjik** i cili permban edhe planimetrine e zones ku ndodhet burimi.

**2.Projekti i shfrytëzimit te rezervës ujore.**

**3.Oponenca e studimit nga Sherbimi Gjeologjik Shqiptar, per rastet e pus-çpimeve.**

(\_\_\_\_\_)

## SQARIME PER DOKUMENTACIONIN TEKNIK

### 1. RAPORTI HIDROLOGJIK OSE HIDROGJEOLGJIK PER BURIMIN UJOR

#### A- Teksti duhet te permbaje:

Te dhena te pergjitheshme hidrologjike (hidrografi,klime,etj.)

- Pershkrimi gjeologo-morfologjik i zones.
- Pershkrimi i punimeve studimore te kryera ne burimin uJOR te kerkuar
- Rezultatet e punimeve studimore te kryera (shpime,galeri,pompime,etj)
- Llogaritja e rezervave uJore dhe formulat e perdorura,perfshi % e sigurise.
- Te dhena fiziko-kimike dhe bakeorologjike per burimin uJOR (analiza laboratorike) dhe komente per to.
- Perfundime
- Rekomandime per menyren e kaptazhit dhe te rregjimit te perdorimit te burimit uJOR per vendosjen e zonave sanitare (kur perdoret per pirje),etj.
- Bibliografi

#### B. PJESA GRAFIKE duhet te permbaje :

- Harten hidrologjike ose hidrogjeologjike te zones,ne nje shkalle te detajuar,jo me te vogel se 1:25.000,shoqeruar me profilet perkatese.
- Planimetrine e zones se burimit uJOR (ne shkalle 1:500 ose 1:1000)duke perfshire edhe konturet e tokave perreth dhe emrat e pronareve.Ne rastin kur uji i burimit parashikohet te transportohet,se bashku me planimetrine e zones se burimit kerkohe dhe planimetria e gjurmes se ujesjellesit (tubacioni,kanali etj.) dhe stacionit te pompimit po ne te njejten shkalle.
- Ne rastet kur parashikohen shfrytezim ujrash nentokesore, te paraqiten prerjet gjeologo-teknike te puseve ose skema dhe prerjet hidrogjeologjike te punimit minerar apo cdo lloj kaptazhi tjeter te parashikuar me dimensioned perkatese.

### 2.PROJEKTI I SHFRYTEZIMIT TE REZERVES UJORE duhet te permbaje :

- *Te dhena te pergjitheshme mbi kushtet e shfrytezimit*
- Percaktimi i sasise mesatare te ujit te nevojshem per aktivitetin,ndare ne aktivitet kryesore dhe ndihmese (m<sup>3</sup>/dite,1/sec)
- Aktiviteti qe do te kryhet dhe regjimi i punes ditor, mujor dhe vjetor.
- Punimet per kaptazhin, instalimet hidroteknike etj.

*Te dhena per shkarkimet*

- Vendi dhe menyra e shkarkimit te ujit te perdorur.

*Pjesa grafike e projektit :*

- Skemat perkatese te ndertimit dhe shfrytezimit.